

VENDIM I PAPRANUESHMËRISË

Data e miratimit: 10 prill 2013

Nr. i lëndës: 2012-06

Z

Kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me **8 dhe 10 prill 2013**, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim::

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar
Znj. Katja DOMINIK, anëtare

Ndihmuar nga
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore
Z. Florian RAZESBERGER, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së sipërpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e cila së fundi ka pësuar ndryshime më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa është regjistruar më 30 maj 2012.
2. Më 20 nëntor 2012 Paneli ka kërkuar nga parashtruesi i ankesës të paraqes informata shtesë.
3. Më 21 nëntor 2012, Paneli ka vendosur që të njoftoj rreth ankesës Shefin e Misionit (ShM) të EULEX-it në Kosovë, duke e ftuar atë që të dorëzoj vërejtje me shkrim rreth kësaj ankese.

4. Vërejtjet e ShM janë pranuar më 20 dhjetor 2012. Më pas ato i janë dërguar parashtruesit të ankesës për komente të tij.
5. Më 1 janar 2013, Paneli ka pranuar dokumente nga përfaqësuesi i ri i parashtruesit të ankesës, duke konfirmuar kompetencat e tij si avokat dhe duke parashtruar informata shtesë.
6. Më 7 shkurt 2013, parashtruesi i ankesës ka parashtruar vërejtjet e tij shtesë, të cilat u janë dërguar ShM për njoftim.
7. Paneli ka pranuar dëshirën e parashtruesit të ankesës që mos të bëhet publik emri i tij. Prandaj ai do të referohet si Z.

II. FAKTET

8. Faktet e lëndës, siç janë parashtruar nga Z, mund të përmbliidhen si në vijim:
9. Më 13 janar 2012, pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it për paraburgimin e parashtruesit të ankesës, gjykatësi i procedurës paraprake i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ka urdhëruar që Z të mbahet në paraburgim për 30 ditë. Z është ankuar ndaj këtij vendimi. Më 17 janar 2012, një trup gjykues i përbërë prej tre gjykatësve të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës kanë hedhur poshtë ankesën e tij.
10. Më 6 shkurt 2012, gjykatësi i procedurës paraprake në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës ka refuzuar kërkesën për të përcaktuar ligjshmërinë e paraburgimit të parashtruar në emër të Z.
11. Më 10 shkurt 2012, pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it për vazhdim të paraburgimit, trupi gjykues i përbërë prej tre gjykatësve ka urdhëruar që paraburgimi i Z të vazhdoj deri më 12 prill 2012. Z është ankuar kundër këtij vendimi. Më 22 shkurt 2012, ankesa e tij ishte hedhur poshtë nga Gjykata Supreme.
12. Më 11 prill 2012, pas kërkesës së prokurorit të EULEX-it për vazhdim të paraburgimit, gjykatësi i procedurës paraprake ka urdhëruar që paraburgimi i Z të vazhdoj deri më 12 maj 2012. Z është ankuar kundër këtij vendimi. Kjo ankesë ishte hedhur poshtë nga trupi gjykues prej tre gjykatësve të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës më 15 prill 2012.
13. Më 7 maj 2012, prokurori i EULEX-it prapë ka kërkuar nga trupi gjykues prej tre gjykatësve të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës që ta vazhdoj paraburgimin edhe për dy muaj.
14. Më 11 maj 2012, trupi gjykues i përbërë prej tre gjykatësve në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës ka vazhduar paraburgimin e Z deri më 12 korrik 2012.

15. Në një shtojcë të këtij vendimi të datës 14 maj 2012, Gjykata e Qarkut e Prishtinës ka konstatuar se çfarëdo kërkesë tjetër nga prokurori për vazhdimin e paraburgimit të parashtruesit të ankesës duhet të mbështetet nga një kronologji e hollësishme që tregon: i) çfarë veprime ishin ndërmarrë dhe kryer gjatë hetimit që prej se ishte lëshuar vendimi i fundit për paraburgim; ii) çfarë masa hetimore dhe veprime kanë mbetur për tu marrë dhe kryer; dhe iii) një shpjegim përse këto veprime kanë mbetur të papërfunduara.
16. Më 18 maj, Gjykata Supreme e Kosovës ka refuzuar ankesën e Z kundër vendimit të trupit gjykues prej tre gjykatësve të datës 11 maj 2012.
17. Më 4 korrik 2012, prokurori i EULEX-it ka ngritur një aktakuzë kundër parashtruesit të ankesës dhe të tjerëve.
18. Më 9 korrik 2012, një trup gjykues i përbërë prej tre gjykatësve të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ka vazhduar paraburgimin për edhe dy muaj të tjerë, deri më 12 shtator 2012. Më 18 korrik 2012, Gjykata Supreme e Kosovës ka hedhur poshtë ankesën e parashtruar nga Z kundër vazhdimin të paraburgimit.
19. Më 10 shtator 2012, një trup gjykues i përbërë prej tre gjykatësve të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ka vazhduar paraburgimin për edhe dy muaj të tjerë, deri më 12 nëntor 2012.
20. Më 8 tetor 2012, një aktakuzë e datës 4 korrik 2012 ishte konfirmuar nga gjykatësi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës.
21. Më 8 nëntor 2012, kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ka vazhduar paraburgimin deri më 12 janar 2013. Z nuk është ankuar kundër këtij vendimi, mirëpo ka parashtruar një kërkesë më 12 dhjetor 2012 për ndërprerjen e menjëhershme të atij paraburgimi. Më 27 dhjetor, kryetari i trupit gjykues i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ka refuzuar këtë kërkesë.
22. Më 7 shkurt 2012, përfaqësuesi i parashtruesit të ankesës ka njoftuar Panelin se Z ishte liruar nga paraburgimi dhe ishte vënë në arrest shtëpiak.

III. ANKESAT

23. Parashtruesi i ankesës pretendon se ka shkelje të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ). Në veçanti, ai pretendon se as ai e as avokati i tij mbrojtës nuk kanë pasur qasje në dokumente të dosjes së lëndës, prandaj ata *“nuk ishin në gjendje që në mënyrë efektive të kundërshtonin nevojën për paraburgim”*.

24. Parashtruesi i ankesës pretendon që kërkesat e prokurorit për paraburgim dhe vendimet përkatëse gjyqësore për vazhdimet e paraburgimit ishin të bazuara në prova të pamjaftueshme. Ai kundërshton saktësinë e argumenteve të parashtruara në kërkesën e prokurorit për vazhdimin e paraburgimit të tij.
25. Parashtruesi i ankesës i referohet Nenit 5, paragrafi 3 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ). Ai pohon se Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ("Gjykata") në mënyrë të përsëritur ka konstatuar shkelje të së drejtës për tu gjykuar brenda një afati të arsyeshëm apo për lirim deri në pritje të gjykimit që vijnë si pasojë e periudhave të gjata të mos veprimit në trajtimin e lëndës para gjykimit, vonesave të shkaktuara nga ekspertët, personel të pamjaftueshëm, praktika të papërshtatshme të punës së autoriteteve dhe vështirësive që dalin nga nevoja për të mbrojtur identitetin e një dëshmitari të mbrojtur. Ai pohon se prokuroria në kërkesat për vazhdimin e paraburgimit të tij ishte bazuar në disa prej këtyre arsyeve. Ai pohon se më këtë ishte shkelur e drejta e tij për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm apo për tu liruar deri në pritje të gjykimit.
26. Parashtruesi i ankesës bazohet në nenin 10 dhe nenin 11, paragrafi 1 i Deklaratës së Përgjithshme të të Drejtave të Njeriut; në nenin 5, paragrafi 1c, 2, 3 dhe 4, nenin 6, paragrafi 1, 2, 3a, 3b dhe 3d, i KEDNJ; në nenin 9, paragrafi 2 deri 4 i Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike; dhe në nenin 6, paragrafi 1 dhe 2 i Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve a dënimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose poshtëruese.

IV. LIGJI

Pranueshmëria

27. Para shqyrtimit të meritave të ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranojnë ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
28. Sipas rregullës 25, paragrafi 1 i rregullores së punës, Paneli mund të shqyrtojë ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv.
29. Sipas rregullës të përmendur më lart, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, Paneli nuk mund të shqyrtoj procedurat ligjore që janë pranë gjykatave të Kosovës.

Kompetencat e Panelit

30. ShM ka pohuar se rrethanat e kësaj lënde hyjnë në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it.
31. Paneli nuk ka kompetencë mbi aspektet administrative apo juridike të punës së gjykatave të Kosovës. Përkundër faktit se gjykatësit e EULEX-it janë pjesë e trupit gjykues të Gjykatës së Qarkut të Prishtinës dhe/apo të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk do të thotë se ajo gjykatë nuk është pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih ndër të tjera, *Halili kundër EULEX-it*, 2012-08, 15 janar 2013, në paragrafin 21 *Pajaziti kundër EULEX-it*, 2012-05, 4 tetor 2012 në paragrafët 9-10 *Dobruna kundër EULEX-it*, 2012-03, 4 tetor 2012 në paragrafin 12 *Zeka kundër EULEX-it*, 2012-02, 4 tetor 2012 në paragrafin 21).
32. Në anën tjetër, Paneli tashmë ka konstatuar se veprimet e prokurorëve të EULEX-it apo të policisë të ndërmarrë brenda kontekstit të hetimeve penale janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë dhe prandaj hyjnë në kuadër të mandatit të Panelit (shih p.sh. *W kundër EULEX-it*, 2011-07, 5 tetor 2012 në paragrafin 21; *Hoxha kundër EULEX-it*, 2011-18, 23 nëntor 2011 në paragrafin 22; *S.M. kundër EULEX-it*, 2011-11, 23 nëntor 2011 në paragrafin 15).
33. Paneli më tej ka konstatuar se veprimet apo mos veprimet e prokurorëve gjatë fazës së hetimit të procedurave penale mund të mos konsiderohen se bëhen në kontekst të “procedurave gjyqësore” (shih *Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, 14 shtator 2011, paragrafi 64). Lidhur me këtë, Paneli konstaton se “veprimet dhe mos veprimet e prokurorëve të EULEX-it [...] para dorëzimit të aktakuzës mund të hyjnë brenda kuadrit të mandatit ekzekutiv të EULEX-it” (shih *Thaqi kundër EULEX-it*, 2010-02, 14 shtator 2011, paragrafi 93).
34. Paneli tashmë ka gjetur se ai ka kompetencë për të shqyrtuar veprimet dhe vendimet e marra nga prokurorët e EULEX-it në kontekst të hetimeve penale. Për më tepër, nuk mund të përjashtohet se në rrethana të caktuara kompetencat e Panelit do të përfshijë vendimet dhe aktet e autoriteteve të ndjekjes në hetimet penale madje edhe kur ato i ishin nënshtruar një shqyrtimi gjyqësor të mëvonshëm. Paneli është i mendimit se do të ketë kompetencë për të shqyrtuar këto akte dhe vendime të tilla, aty ku çështja e akteve dhe vendimeve që është subjekt i këtij shqyrtimi prek të drejtat e njeriut, p.sh. të drejtën për liri personale dhe sipas kuptimit të nenit 5 të KEDNj. Paneli do të ndërhyjë vetëm nëse dhe kur akuzat për shkeljet e të drejtave të njeriut, që i ngarkohen prokurorit, nuk janë trajtuar plotësisht nga autoritetet kompetente gjyqësore.
35. Paneli do të shqyrtoj këtë lëndë duke i marrë parasysh këto.
36. Duke u kthyer tek rrethanat e kësaj lënde, Paneli konstaton se parashtuesi i ankesës, në thelb, kundërshton vendimet e marra nga

gjykatat sa i përket caktimit të paraburgimit të tij dhe vazhdimit të atij paraburgimi, dhe pajtueshmërinë e këtyre vendimeve me standardet e të drejtave të njeriut, në veçanti për atë që ato i garantojnë të pandehurit gjatë procedurave penale të drejtën në liri dhe siguri personale. Për më tepër, parashtruesi i ankesës ka pohuar se në procedurat lidhur me caktimin dhe vazhdimin e paraburgimit të tij, avokati i tij mbrojtës nuk ka pasur qasje në dokumentet e dosjes së lëndës, prandaj *“nuk ka qenë në gjendje që në mënyrë efektive të kundërshtoj nevojën për paraburgim”*.

Neni 5, paragrafi 4 KEDNj – qasja në dokumente gjatë procedurave lidhur me paraburgim

37. ShM ka pohuar se procedurat në të cilat parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të kundërshtoj ligjshmërinë e paraburgimit të tij ishin në përputhje me nenin 5, paragrafin 4 të Konventës.
38. ShM ka pohuar se sipas jurisprudencës së KEDNj, prokuroria nuk ka pasur obligim që të zbuloj çfarëdo dokumenti që kishte në dispozicion. Është dashur që vetëm të lejoj qasjen në dokumente, të cilat ishin të domosdoshme në mënyrë që të kundërshtohet në mënyrë efektive ligjshmëria e paraburgimit.
39. ShM ka pohuar se në këtë lëndë, informata që i është ofruar mbrojtjes kishte qenë më shumë se e mjaftueshme për t'i siguruar mbrojtjes mundësi reale për të komentuar mbi argumentet e prokurorisë.
40. ShM më tej ka deklaruar se parashtruesi i ankesës ka pasur qasje të plotë në dosjen e lëndës që nga fundi i muajit korrik 2012, pas ngritjes së aktakuzës në gjykatë. ShM më tej ka deklaruar se as i pandehuri e as avokati i tij nuk kishin saktësuar cilat dokumente ata i konsideronin se ishin të domosdoshme për ta për ta kundërshtuar ligjshmërinë e paraburgimit të tij. Në thelb, ShM ka pohuar se asnjëherë nuk ishte dorëzuar ndonjë kërkesë për kontrollimin e dosjeve tek prokuroria.
41. Në përgjigje, parashtruesi i ankesës ka deklaruar se prokuroria kishte dështuar të ofroj qasje në dokumentet e dosjes së lëndës, sidomos në fillim të hetimit. Ai ka dhënë një shembull të seancës paraprake të datës 19 nëntor 2012, kur kryetari i trupit gjykues nuk ka mundur të gjej deklaratat e të gjithë dëshmitarëve që prokuroria i kishte propozuar në dosjen e lëndës, për të cilën prokurori është përgjigjur duke thënë se ai i kishte hequr dy deklaratat, i kishte marrë ato prapë dhe kishte *“fatur gjithçka që ata kanë thënë”*.
42. Më tej, parashtruesi i ankesës ka pohuar se mbrojtja do të përgatis një listë të provave, që ishin vendimtare për të kundërshtuar në mënyrë efektive paraburgimin e tij. Megjithatë, më vonë Panelit nuk ishte ju ishte dorëzuar asnjë listë e tillë.
43. Paneli konstaton se parashtruesi i ankesës nuk ka saktësuar, sipas mendimit të tij, se kush ishte përgjegjës për qasjen e pamjaftueshme

në dosjen e lëndës, autoritetet e ndjekjes apo gjykatat. Sipas mendimit të tij, Paneli do të ketë juridiksion për të shqyrtuar këtë ankesë nëse do të ishte treguar se autoritetet e ndjekjes ishin përgjegjës për ndonjë defekt të dyshuar (shih paragrafët 31 - 32 më lart) ose që aplikanti e kishte ngritur këtë ankesë shprehimisht pranë gjykatave, të cilat nuk ju ishin përgjigjur (shih paragrafin 34 më lart).

44. Megjithatë, në mungesë të çfarëdo shenje dëshmie që sipas pikëpamjes së parashtruesi të ankesës ishte e domosdoshme për të kundërshtuar në mënyrë efektive nevojën për paraburgimin e tij, dhe çka është më e rëndësishmja duke pasur parasysh faktin se parashtruesi i ankesës nuk ka treguar se ai, shprehimisht apo në thelb, e ka ngritur këtë çështje në ankesat e tij, kështu për t'i ofruar gjykatës një mundësi për ta trajtuar atë, Paneli është i mendimit se nuk ka juridiksion për të shqyrtuar këtë pjesë të ankesës.

Neni 5 paragrafi 1 dhe 5 paragrafi 3 KEDNJ – Ligjshmëria dhe kohëzgjatja e paraburgimit

45. ShM pohon se vendimet relevante ishin në përputhje me standardet e ligjshmërisë brenda kuptimit të nenit 5 të KEDNJ. Është argumentuar se ai paraburgim ishte shqyrtuar nga gjykatat në intervale të rregullta dhe në secilin rast ajo ishte vlerësuar nëse rrethanat kanë vazhduar ta arsyetojnë privimin e lirisë.
46. Shefi i Misionit më tej pohon se paraburgimi i parashtruesit të ankesës kishte qenë i bazuar jo vetëm në një dyshim të arsyeshëm se ai kishte kryer veprat në fjalë, mirëpo edhe në rrezikun e arratisjes dhe më e rëndësishmja e një ndërhyrje të mundshme në hetimin. Hollësitë dhe faktorët e dhënë nga Gjykata e Qarkut e Prishtinës dhe nga Gjykata Supreme e Kosovës tregojnë se ka pasur kujdes të veçantë nga autoritetet shtetërore gjatë kryerjes së proceduarve, siç kërkohet nga GjEDNJ (GjEDNJ, *Kudla kundër Polonisë*, GC vendimi i datës 26 tetor 2000 në paragrafin 11).
47. Më tej, ShM ka deklaruar se duke pasur parasysh kompleksitetin e kësaj lënde të krimeve financiare, "prokurori [kishte] vepruar me shpejtësi, duke e trajtuar padinë e lëndës brenda gjashtë muajve të paraburgimit".
48. Në përgjigjen e tij, Z ka pohuar se vendimet e gjykatave mbi vazhdimin e paraburgimi nuk ishin të bazuara në arsye relevante dhe të mjaftueshme dhe se autoritetet nuk kishin shfaqur kujdes të veçantë në kryerjen e hetimit.
49. Paneli vëren se, siç përcaktohet në paragrafin 9-22 më lart, parashtruesi i ankesës ka kaluar një periudhë prej më shumë se një vit në paraburgim, para se të vendosej në arrest shtëpiak. Gjatë kësaj kohe, urdhri për paraburgim ishte vazhduar gjashtë herë.

50. Paneli vëren se të gjitha vendimet mbi paraburgimin e parashtruesit të ankesës, qoftë në lidhje me shqiptimin e saj dhe më pas në lidhje me vazhdimin e saj janë dhënë nga autoritetet gjyqësore. Këto vendime ishin ankimuar nga parashtruesi i ankesës dhe më pas ankesat e tij ishin shqyrtuar nga gjykatat e apelit. Gjykatave ju ishte dhënë një mundësi për të shqyrtuar parashtruesat e parashtruesit të ankesës që kundërshtonin ligjshmërinë e urdhrin për paraburgim të tij dhe të vendimeve të mëvonshme që e vazhdonte paraburgimin e tij për perioda të mëtejshme.
51. Si pasojë, duke pasur parasysh faktin se paraburgimi i parashtruesit të ankesës ishte shqiptuar nga gjykata dhe se ligjshmëria e tij ishte shqyrtuar më vonë, pas ankesave nga parashtruesi i ankesës dhe nga gjykatat, Paneli nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesat që kanë të bëjnë me mënyrën me të cilën Gjykata e Qarkut e Prishtinës dhe/apo Gjykata Supreme e Kosovës ka shqyrtuar ligjshmërinë e tij (shih paragrafin 31 më lart).
52. Pra si rezultat i kësaj, çështjet e ngritura këtu nuk do të shqyrtohen nga Paneli, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së punës dhe OPLAN-it të EULEX-it.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI,

konstaton se kjo ankesë bie jashtë kompetencave të Panelit sipas kuptimit të nenit 29 (d) të rregullores së punës, dhe

SHPALL KËTË ANKESË TË PAPRANUESHME.

Për Panelin,

John J. RYAN
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA
Kryesues i Panelit